



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M
K.P.P. 375/2021

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 15/07/2021, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Marrjen e masës administrative gjobë ndaj z. Adrian Gurma, Titullar i Autoritetit Kontraktor, Bashkia Sarandë, për mos bashkëpunim me Komisionin e Prokurimit Publik për procedurën e prokurimit me nr. *Kërkesë për Propozim*”, me nr. REF- 91898-03-30-2021, me objekt “*Rrugë të brendshme me beton në lagjen nr. 1 (Amerikane), rruga “Nazif Bezhani”, rruga “Sabri Preveza”, me fond limit 5.791.360 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 14.04.2021, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Sarandë.*

Drejtuar: Z. Adrian Gurma.
Adresa: Rruga “Abedin Dino”, Lagjia Nr. 1, Bashkia Sarandë.

Baza Ligjore: Ligji Nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, nenit 24 dhe 131 e vijues, Ligjit Nr. 10279 datë 20.5.2009 “*Për kundërvajtjet administrative*”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”.*

Komisioni i Prokurimit Publik,

Vëren:

I

- 1- Në datën 19.05.2021 operatori ekonomik “Tea D” shpk ka dorëzuar ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik në lidhje me procedurën e prokurimit *Kërkesë për Propozim*”, me nr. REF- 91898-03-30-2021, me objekt “*Rrugë të brendshme me beton në lagjen nr. 1 (Amerikane), rruga “Nazif Bezhani”, rruga “Sabri Preveza”, me fond limit 5.791.360 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 14.04.2021, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Sarnadë.*
- 2- Në datën 24.05.2021, me shkresën nr. 855/1 prot, Komisioni Prokurimit Publik i është drejtuar operatorit ekonomik ankimues nga i cili kërkon një kopje të ankesës drejtuar autoritetit kontraktor.
- 3- Në datën 25.05.2021, me shkresën nr. 855/2 prot., është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik shkresa e operatorit ekonomik ankimues bashkalidhur së cilës ndodhet një kopje e ankesës drejtuar autoritetit kontraktor.
- 4- Në datën 25.05.2021 me anë të Vendimit nr. 855/3 Protokolli, Komisioni i Prokurimit Publik ka vendosur pezullimin e procedurës së mësipërme të prokurimit si edhe ka detyruar autoritetin kontraktor të dërgojë informacionin e kërkuar “*jo më vonë se 5 ditë nga data e marrjes së këtij vendimi*”
- 5- Me shkresën me nr. 855/4 prot., datë 22.06.2021, Komisioni i Prokurimit Publik, ka dërguar shkresën me objekt “Rikërkesë për informacion”, autoritetit kontraktor pasi sërish nuk është paraqitur dokumentacioni dhe informacioni i kërkuar dhe konkretisht informacion të hollësishëm dhe të detajuar mbi procedurën e mësipërme të prokurimit, në me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues “Tea D” SHPK, si dhe veprimet në sistemin elektronik të prokurimeve në lidhje me trajtimin e ankesës, gjithashtu në informacion të pasqyrohet procesi i vlersimit të procedurës si dhe të jepen argumentimet përkatëse mbi pretendimet e operatorit ekonomik “Tea D” SHPK, të vërtetuar me dokumentacion për trajtimin e ankesës.
- 6- Duke nisur nga data 22.06.2021 autoriteti kontraktor Bashkia Sarandë ka refuzuar të bashkëpunojë me Komisionin e Prokurimit Publik duke mos dërguar informacionin e kërkuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të dokumentacionit

Arsyeton

II.1. Në nenin 131 pika 1 dhe 2 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” parashikohet se : “1. Refuzimi i autoritetit ose entit kontraktor për të bashkëpunuar me Komisionin e Prokurimit Publik dhe Agjencinë e Prokurimit Publik ngarkon me përgjegjësi titullarin e autoritetit kontraktor dhe dënohet nga këto institucione me gjobë nga 50 000 (pesëdhjetë mijë) deri në 500 000 (pesëqind mijë) lekë. 2. Masa e gjobës vendoset në raport me vlerën e përllogaritur të kontratës dhe sipas përcaktimeve në rregullat e prokurimit publik”.

II.2. Në datën 19.05.2021 operatori ekonomik “Tea D” shpk ka dorëzuar ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik në lidhje me procedurën e prokurimit “Kërkesë për Propozim”, me nr. REF-91898-03-30-2021, me objekt “Rrugë të brendshme me beton në lagjen nr. 1 (Amerikane), rruga “Nazif Bezhani”, rruga “Sabri Preveza”, me fond limit 5.791.360 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 14.04.2021, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Sarnadë.

II.2.1. Në datën 24.05.2021, me shkresën nr. 855/1 prot, Komisioni Prokurimit Publik i është drejtuar operatorit ekonomik ankimues nga i cili kërkon një kopje të ankesës drejtuar autoritetit kontraktor.

II.2.2. Në datën 25.05.2021, me shkresën nr. 855/2 prot., është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik shkresa e operatorit ekonomik ankimues bashkalidhur së cilës ndodhet një kopje e ankesës drejtuar autoritetit kontraktor.

II.2.3. Në datën 25.05.2021 me anë të Vendimit nr. 855/3 Protokolli, Komisioni i Prokurimit Publik ka vendosur pezullimin e procedurës së mësipërme të prokurimit si edhe ka detyruar autoritetin kontraktor të dërgojë informacionin e kërkuar “ jo më vonë se 5 ditë nga data e marrjes së këtij vendimi”

II.2.4. Me shkresën me nr. 855/4 prot., datë 22.06.2021, Komisioni i Prokurimit Publik, ka dërguar shkresën me objekt “Rikërkesë për informacion”, autoritetit kontraktor pasi sërish nuk është paraqitur dokumentacioni dhe informacioni i kërkuar dhe konkretisht informacion të hollësishëm dhe të detajuar mbi procedurën e mësipërme të prokurimit, në me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues “Tea D” SHPK, si dhe veprimet në sistemin elektronik të prokurimeve në lidhje me trajtimin e ankesës, gjithashtu në informacion të pasqyrohet procesi i vlersimit të procedurës si dhe të jepen argumentimet përkatëse mbi pretendimet e operatorit ekonomik “Tea D” SHPK, të vërtetuar me dokumentacion për trajtimin e ankesës.

II.2.5. Duke nisur nga data 22.06.2021 autoriteti kontraktor Bashkia Sarandë ka refuzuar të bashkëpunojë me Komisionin e Prokurimit Publik duke mos dërguar informacionin e kërkuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

II.3. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se me anë të mos veprimit autoritetit kontraktor ka refuzuar të bashkëpunojë me Komisionin e Prokurimit Publik duke mos dërguar informacionin e kërkuar si edhe një herazi duke zvarritur afatin e zhvillimit të procedurës së prokurimit. Sa më sipër, në proporcion me natyrën dhe volumin e kontratës së procedurës së prokurimit, si edhe duke marrë në konsideratë faktin se zyrtari përgjegjës nuk është përsëritës në shkeljen administrative, në mbështetje të nenit 24 nenit 131 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, Ligjit Nr. 10279 datë 20.5.2009 “Për kundërvajtjet administrative”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik” Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

- 1- Të marrë masën administrative gjobë në masën 50,000 (pesëdhjetë mijë) lekë për z. Adrian Gurma, Titullar i Autoritetit Kontraktor Bashkia Sarandë, për mos bashkëpunim me Komisionin e Prokurimit Publik për procedurën e prokurimit *Kërkesë për Propozim*”, me nr. REF- 91898-03-30-2021, me objekt “*Rrugë të brendshme me beton në lagjen nr. 1 (Amerikane), rruga “Nazif Bezhani”, rruga “Sabri Preveza”, me fond limit 5.791.360 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 14.04.2021, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Sarnadë.*
 - 2- Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Monitorimit Shërbimeve Mbështetëse dhe Financës pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe Shërbimi Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror.
 - 3- Kjo gjobë përbën titull ekzekutiv.
 - 4- Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë në përputhje me Ligjin nr. 10279 datë 20.5.2009 “Për kundërvajtjet administrative”.
 - 5- Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaid Myzyri